Kuvajti është shteti i radhës që ka njohur pavarësinë e Kosovës. Lajmin e ka bërë të ditur përmes rrjetit social Twitter, zëvendësministri i punëve të jashtme, Petrit Selimi. Njohja vije pak ditë pas vizitës së një delegacioni të lartë nga Kuvajti në Kosovë,

kurse këto ditë atje po qëndron edhe një delegacion nga Kosova në krye me Ministrin e Jashtëm, Enver Hoxhaj. Ky i fundit po zhvillon takimet me zyrtarët më të lartë të shtetit të pasur. Gjatë ditës priten informacione shtesë për këtë njohje.**/indeksonline/**



Phoca PDF